



KONTRATE THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR 'KAJO' SHPK

Ne ortakët :

1. Shkelqim Kajo I biri Osmanit lindur me 1963 banues ne Berat
 2. Vladimir Kajo I biri Osmanit lindur me 1978 banues ne Berat
- konforme ligjes 7638 date 19.11.1992 dhe ligjes 7667 date 28.1.1993 hartojme kete kontrate per themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 1

Shoqeria emertohet "KAJO" SHPK.

Neni 2

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete : Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore si dhe import eksperti I tyre.

Neni 3

Selia e shoqerise do te jete ne fshatin Poshnje Berat.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Neni 5

Administratori I shoqerise do te jete zoti Shkelqim Kajo

Neni 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 leke I depozituar ne degen e bankes kombetare tregtare Berat I ndare ne kuota te barabarta midis dy ortakëve nga 50% sejcili.

Neni 7

Pjese te kapitalit jane te transferueshme ne rruge trashgimie apo edhe brenda familjes ose edhe personave te trete por gjithmone me pelqimin e te dy ortakëve.

Neni 8

Shoqeria ka te drejte te krijojë filiale ne gjithe territorin e vendit apo edhe jashte tij si dhe te lidhet me shoqeri te tjera analoge.

Neni 9

Shoqeria e fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne gjykatën e shkalles pare Tirane dhe organet tatimore te vendit ku ajo kryen veprimtarine e saj.

ORTAKET THEMELUES

Shkelqim Kajo

Vladimir Kajo



STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR 'KAJO' SHPK

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria krijohet ne mbeshtetje te ligjes 7638 date 19.11.1992 per shoqerite tregetare dhe ligjes 7667 date 28.1.1993 per regjistrin tregetar si dhe legjislacionit tjeter shqiptar ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria krijohet nga oretaket themelues : 1.Shkelqim Kajo I biri Osmanit lindur me 1963 banues ne Berat dhe 2.Vladimir Kajo I biri Osmanit lindur me 1978 banues ne Berat,persona madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 3

Shoqeria emertohet " KAJO " dhe eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar shpk.

KOHEZGJATJA DHE OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne fshatin Poshnje Berat.

Neni 6

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte : Tregetim me shumice dhe pakice I artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore,import eksporti I tyre.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 leke I depozituar ne degen e bankes kombetare tregetare Berat I ndare ne kuota te barabarta midis dy ortakeve nga 50% sejcili.

Neni 8

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen ne rruge trashegimie ose brenda familjes ose edhe personave te tjere qe nuk bejne pjese ne shoqeri por gjithmone me pelqimin e ortakeve themelues.

DREJTIMI DHE ADMIISTRIMI

Neni 9

Organet dretuese te shoqerise jane :
Asambleja e Ortakeve

Administratori

Neni 10

Asambleja e Ortakeve ka per detyre :

- Organizon dhe drejton gjithë veprimtarine e shoqerise
- Emeron administratorin dhe cakton kopetencat e tij
- Emeron dhe shkarkon ekspertin kontabel.
- Regullon mardheniet e punesimit dhe shperblimit ne shoqeri
- Vendos zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar
- Vendos shnderrimin e shoqerise ne forma te tjera
- Vendos per ndryshime ne statut.
- Vendos per shitjen e pjeseve te kapitalit
- Vendos per shperberjen e shoqerise etj.
- Miraton bilancin vjetor
- Ne rast te prishjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.

Vendimet per ndryshimet ne statut,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar e per prishjen e shoqerise apo shnderimin e saj ne forma te tjera meren me miratimin unanim te te dy ortakeve.

Neni 11

Administrator I shoqerise eshte zoti Shkelqim Kajo

Neni 12

Administratori ka per detyre :

- Drejton veprimtarine ekonomike te shoqerise
- Raporton periodikisht per veprimtarine e shoqerise
- Lidh kontratat e punes dhe I firmos ato ne emer te shoqerise
- Perfaqeson shoqerine ne organet e ndryshme
- Autorizon persona te tjere per te perfaqesuar shoqerine
- Depoziton firmen ne banke
- Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne emer te shoqerise pervec atyre qe I jane lene ne kopetence asamblese se ortakeve.

Neni 13

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise,por ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe aktet e administratorit kalonin kopetencat e tij apo objektin e shoqerise.

MARDHENIET FINANCIARE

Neni 14

Shoqeria mund te lidh kontrata me shtetin, persona te ndryshem fizike apo juridike, vendas apo te huaj sipas legjislacionit ne fuqi

Neni 15

Te drejtat dhe detyrimet qe rjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe per punonjesit e saj.

Neni 16

Shoqeria operon sipas cmimeve te ekonomise se tregut, kerkeses dhe ofertes.

Neni 17

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore etj.

Shoqeria cel llogari likujduese ne banke.

Neni 18

Per pasqyrimin e veprimtarise ekonomike te shoqerise administratori ose persona te ngarkuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumente te regullta financjare si dhe regjistrat perkates te llogarive konforme ligjeve ne kete fushe.

Neni 19

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbyllet ne muajin Dhjetor te cdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqes bilanc vjetor se bashku edhe me deklaraten e te ardhurave, firmeve apo humbjeve dhe tidorzoj ato ne zyren tatimore perkatese.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 20

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve te ndryshme, sigurimeve shoqerore etj kalojne ne pronesi te te dy ortakeve.

Neni 21

Shperblimi per personat e punesuar caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimet ne page vendoset nga asambleja e ortakeve dhe me autorizim te tyre nga administratori.

Neni 22

Shoqeria mban rezerven ne dispozicion te saj e cila perdoret per shperblime, financime apo donacione te ndryshme.

MARRDHENIET E PUNESIMIT

Neni 23

Gjate ushtrimit te veprimtarise saj shoqeria puneson shtetas te ndryshem mardheniet me te cilet regullohen konforme kodit te punes ne fuqi.

Marrja ne pune behet duke lidhur kontraten perkatese te punes ne te cilen pasqyrohen te drejtat dhe detyrat e punedhenesit dhe punemarresit. Kontrata e punes lidhet me ose pa afat.

Neni 24

Shoqeria mban regjistrin themeltar te punonjesve. Ajo me marrjen ne pune te punonjesit ve ne dijeni zyren e punes se rrethit ku ushtron veprimtarine e saj si dhe organet tatimore.

Neni 25

Largimi nga puna behet me akt me shkrim nga administratori. Dorzimi I detyres behet pasi te jene shlyer gjithë detyrimet e mundeshme materjale e monetare. Pas kesaj plotesohet libreza e punes dhe lajmerohet zyra e punes.

SHPERBERJA, PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

Neni 26

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne statut pervec rasteve kur asambleja e ortakeve vendos ndryshe pra zgjat afatin e veprimtarise saj.

Neni 27

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes saj. Per kryerjen e ketij procesi asambleja e ortakeve emerone nje likujdator te clat I paraqesin shoqerise raportin perkates mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te saj, ndjekjen e veprimeve te likujdimit dhe afatin e perfundimit tyre. Pas perfundimit te detyres asambleja vendos shkarkimin e likujdatorit.

MOSMARVESHJET

Neni 28

Si regull mosmarveshjet e ndryshme qe mund te lindin ne shoqeri zgjidhen me mirkuptim e brenda asaj. Kur zgjidhja me pajtim nuk behet e mundur atehere ato zgjidhen gjyqesisht ne gjykatën e vendit ku shoqeria kryen aktivitetin e saj.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 29

Te gjitha ndryshimet e mundeshme ne statut pasqyrohen ne regjistrin tregetar te gjykates shkalles pare Tirane.

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut do te veprohet konforme dispozitave ligjore te cituara ne hyrje te ketij statuti.

Neni 30

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrin ne gjykatën e shkalles pare Tirane dhe organet tatimore te vendit ku ajo ushtron veprimtarine e saj.